REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË**
**DREJTORIA E STREHIMIT SOCIAL DHE MENAXHIMIT TË BANESAVE SOCIALE**

# RELACION

Korçë, më 16. 05. 2024

## MBI
## MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL I STREHIMIT,"SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË"

Në zbatim të programit " Subvencionimi i Interesave të Kredisë" për familjet e pastreha, me fonde të buxhetit të shtetit, Bashkia Korçë vazhdon të zbatojë këtë program deri në plotësim të kuotave të vëna në dispozicion nga MFE.

Subvencionimi i interesave të kredisë, është instrument financiar që siguron strehim social në mungesë të banesave me kosto të ulët.

Kushtet kryesore që duhet të plotësojë aplikanti për të përfituar nga ky program social sipas ligjit të strehimit janë :

1- Të vërtetojnë se nuk kanë banesë në pronësi dhe nuk kanë kryer asnjë transaksion për tjetërsimin e saj të paktën në 5 vitet e fundit, përveç rastit kur pronësia mbi to ka humbur për shkak të një fatkeqësie (vdekje apo sëmundje e rëndë) ose force madhore.
2- Kanë të ardhura familjare/ individuale mujore jo më të larta se të ardhurat mesatare të njësisë së vetqeverisjes vendore përkatëse (Bashkia Korçë),dhe sipas përcaktimit të pikës 45, neni 2 i ligjit të strehimit " të ardhura mesatare " është niveli mesatar i konsumit familjar sipas nivelit më të ulët territorial të disagregimit të të dhënave nga INSTAT-i dhe që publikohet në mënyrë periodike.

Ky programi synon të mbështesë individë /familje në blerjen e shtëpive të para, me qëllim përmirësimin e cilësisë të jetesës. Prioritet i jepet familjeve të reja me moshë të anëtarit më të madh më pak ose baraz me 40 vjeç, individë me moshë jo më shumë se 40 vjet, gra kryefamiljare apo individë /familje të minoritetit rom e egjiptian.

Kategoritë e cilësuara më lart përbëjnë përparësi, por nuk përjashtojnë kategoritë e tjera prioritare që përcakton neni 16 i ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar.

Në përgjigje të njoftimit publik Nr.10507 Prot. datë 6.12.2022 të Bashkisë Korçë thirrjes për "aplikime-kërkesë për të përfituar strehim nga subvencionimi i interesave të kredisë", në sistemin on-line të strehimit, nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, kanë ardhur aplikime të tjera dhe bazuar në dokumentacion, rezultojnë të plotësojnë kushtet për përfitimin nga programi i subvencionimit të interesave të kredisë për vitin 2024 edhe 3 (tre) prej tyre, sipas listës bashkangjitur.Administrimi i kërkesave për të përfituar nga ky program u krye në zbatim të kuadrit ligjor dhe përzgjedhja e familjeve përfituese bëhet sipas sistemit të pikëzimit, miratuar me vendimin nr.96 datë 27.07.2023 të Këshillit Bashkiak .

Kushtet e dhënies së kredisë bazohen në Marrëveshjen Dypalëshe "Për Kreditimin në Kuadër të Programit të Banesave me Kosto të Ulët për Familjet që Përfitojnë Subvencionimin e Interesave të Kredisë" nënshkruar midis palëve, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me bankat e nivelit të dytë Raiffeisen,Banka Kombëtare Tregtare dhe Intesa San Paolo dhe familjet përfitojnë kredi me interes jo më të lartë se 3 % dhe me afat maksimal 30 vjet. Diferenca midis interesit të kredisë hipotekore dhe interesit 3% të kredisë së lehtësuar subvencionohet nga buxheti i shtetit.

Në zbatim të :

-Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore",

-Ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin Social i ndryshuar, neni 15,16, 47, 47/1,

-VKM nr.384, datë 12.06.2019,"Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, proçedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore",

-VKM nr.301, datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit",

-VKM Nr.268 datë 29.04.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr.453,datë 3.07.2019."Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet,që përfitojnë banesë me kosto të ulët ,me kredi të lehtësuar nga shteti",

-V.K.B. nr.96 datë 27.07.2023 "Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve të programit subvencioni i interesave të kredisë" ,mbas vlerësimit dhe me miratimin e Komisionit të Strehimit ju propozojmë për miratim listën e familjeve që plotësojnë kushtet e subvencionimit të interesave të kredisë. Lista përmban 3(tre) familje për tu trajtuar nga ky program sipas formatit të listës bashkangjitur projekt-vendimit (tabela 3).

Drejtore/Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale.
**Mirela Balli**

Drejtore/Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Burimeve Njerëzore.
**Anxhela (Dishnica) Qeramixhi**

KRYETARE E KOMISIONIT TË STREHIMIT
**Benila THEMELI**

**KRYETARI I BASHKISË**
**Sotiraq FILO**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KORÇË

BASHKIA KORÇË

**Drejtoria e Strehimit Social dhe M.B.S.Q**

**Programi i Subvencionimit të interesit të kredisë**

**TABELA Nr.3 - Formati i listës emërore që i bashkangjitet relacionit**

| Nr. | Emri/Atësia/Mbiemri | Përbërja familjare | Struktura e apartame-ntit që përfiton | Kushtet e strehimit(neni 16,germa(a) | Kushtet familjare sociale (neni 16 germa b dhe c) | Të ardhurat mujore neto të familjes | Niveli maksimal i te ardhurave per person/familje (pika45,neni2) | Vlera max e apartame-ntit qe perfiton | Telefon | Pikët nga sistemi i pikezimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 1 | Anisa Adriatik Bregu | 2 | 1+1 | a(1) | b(1)(4),c(12) | 64,705 | 84,232 | 2,750,000 | *0695625055 | 31 |
| 2 | Marinela Artur Ajredini | 1 | G | a(1) | b(5),c(10) | 35,520 | 52,800 | 2,290,000 | *0693920075 | 26 |
| 3 | Linda Ilir Trebicka | 4 | 2+1 | a(1) | b(1),c(12) | 81,457 | 111,658 | 3,206,000 | *0693890382 | 23 |

Drejtore/Drejtoria e Strehimit Social dhe M.B.S.Q
Mirela BALLI

Kryetare e Komisionit të Strehimit
Benila Themeli

KRYETAR I BASHKISË
Sotiraq FILO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KORÇË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**P/VENDIM**

Nr.____________, datë _____________ 2024

**MBI**
**MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL I STREHIMIT "SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin Social, nenin 47, 15,pikat 1,2, 3 , të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", "VKM 384, datë 12.06.2019,"Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, proçedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore" VKM nr.453,date 3.07.2019."për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet,që përfitojnë banesë me kosto të ulët ,me kredi të lehtësuar nga shteti",i ndryshuar me VKM nr.268, VKM nr.301, datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit" dhe V.K.B. nr.96 datë 27.07.2023 "Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve të programit, "Subvencioni i interesave të kredisë", bazuar dhe në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Strehimit dhe Menaxhimit te Banesave Sociale dhe me vlerësimin e Komisionit të Strehimit ,Këshilli Bashkiak Korçë,

**VENDOSI:**

1.Miratimin e 3 (tre) familjeve të cilat përfitojnë nga programi social "Subvencionimi i Interesave të Kredisë ", sipas listës bashkangjitur.
2. Familjet e përcaktuara në listën fituese, të këtij vendimi, të paraqiten pranë institucioneve financiare si: Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare dhe Banka Intesa SanPaolo mbas njoftimit zyrtar që kryen Bashkia Korçë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale .
4. Ky vendim hyn në fuqi 10-ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
**Eva NAÇI**

**Kryetar i Këshillit Bashkiak**
**Ana VERUSHI**

Miratuar me ________vota
Vota Pro______
Vota Kundër______
Vota Abstenim__________
Zbardhur më datë_________

Kodi Postar 7001, Lagjia 12. Blv. "Shen Gjergji" nr 12. Tel. +35582243353, email: info@bashkiakorce.gov.al

BASHKIA KORÇË

KËSHILLI I BASHKISE KORÇË

**Programi I Subvencionimit të interesit të kredisë**

**TABELA Nr.3 - Formati i listës emërore**

| Nr. | Emri/Atësia/Mbiemri | Përbërja familjare | Struktura e apartamentit që përfiton | Kushtet e strehimit(neni 16,germa(a) | Kushtet familjare (neni 16 germa (b) | Të ardhurat mujore neto të familjes | Punësimi | Vlera maksimale e apartamentit | Nr.Tel |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| 1 | Anisa Adriatik Bregu | 2 | 1+1 | a(1) | b(1)(4),c(12) | 60,786 | Privat | 2,750,000 | 0695625055 |
| 2 | Marinela Artur Ajredini | 1 | G | a(1) | b(5),c(10) | 35,520 | Privat | 2,290,000 | 0693920075 |
| 3 | Linda Ilir Trebicka | 4 | 2+1 | a(1) | b(1),c(12) | 81,457 | Privat | 3,206,000 | 0693890382 |

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Ana VERUSHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

KËSHILLI BASHKIAK

# VENDIM

Nr.____________, datë ______________ 2024

## MBI
## MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL I STREHIMIT"SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË"

Në mbështetje të Ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin Social, nenin 47, 15,pikat 1,2, 3 , të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", "VKM 384, datë 12.06.2019,"Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, proçedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore" VKM nr.453,datë 3.07.2019."per masen e subvencionit te interesave te kredise dhe procedurën e dhënies së tij për familjet,që përfitojnë banesë me kosto të ulët ,me kredi të lehtësuar nga shteti",i ndryshuar me VKM nr.268, VKM nr.301, datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit" dhe V.K.B. nr.96 datë 27.07.2023 "Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve të programit, "Subvencioni i interesave të kredisë", bazuar dhe në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Strehimit dhe Menaxhimit të Banesave Sociale , Këshilli Bashkiak Korçë,

## VENDOSI:

1.Miratimin e 3 (tre) familjeve të cilat përfitojnë nga programi social "Subvencionimi i Interesave të Kredisë ", sipas listës bashkangjitur.

2. Familjet e përcaktuara në listën fituese, të këtij vendimi, të paraqiten pranë institucioneve financiare si: Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare dhe Banka Intesa SanPaolo mbas njoftimit zyrtar që kryen Bashkia Korçë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet e Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10-ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

**Kryetar i Këshillit Bashkiak**
**Ana VERUSHI**

Miratuar me ________vota
Vota Pro______
Vota Kundër_______
Vota Abstenim__________
Zbardhur më datë________

BASHKIA KORÇË

KËSHILLI I BASHKISE KORÇË

**Programi I Subvencionimit të interesit të kredisë**

**TABELA Nr.3 - Formati i listës emërore**

| Nr. | Emri/Atësia/Mbiemri | Përbërja familjare | Struktura e apartamentit që përfiton | Kushtet e strehimit(neni 16,germa(a) | Kushtet familjare (neni 16 germa (b) | Të ardhurat mujore neto të familjes | Punësimi | Vlera maksimale e apartamentit | Nr.Tel |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| 1 | Anisa Adriatik Bregu | 2 | 1+1 | a(1) | b(1)(4),c(12) | 60,786 | Privat | 2,750,000 | 0695625055 |
| 2 | Marinela Artur Ajredini | 1 | G | a(1) | b(5),c(10) | 35,520 | Privat | 2,290,000 | 0693920075 |
| 3 | Linda Ilir Trebicka | 4 | 2+1 | a(1) | b(1),c(12) | 81,457 | Privat | 3,206,000 | 0693890382 |

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Ana VERUSHI